

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMEVE

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 33
ANNEX - RAPORT AUDITIMI AKTUARISTIK	

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Këshillin Administrativ të Kosovës BYROJA KOSOVARE E SIGURIMEVE

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të BYROJA KOSOVARE E SIGURIMEVE ("Byroja" ose BKS), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financier më 31 Dhjetor 2017, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në fonde dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimëve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së diskutuar dhe efekteve të mundshme në paragrafët 1, 2 dhe 3, pasqyrat financiare të Byrosë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financier të Byrosë së sigurimit të Kosovës më 31 Dhjetor 2017 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në fonde dhe rrjedhën e parasë për periudhën që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës (rregullat e BQK-së).

Baza për Opinion të kualifikuar

- Siç është shpalosur në Shënimin 19 të pasqyrave financiare shoqëruese më 31 Dhjetor 2017, përfshirë në detyrimet tjera, bilanci i detyrimeve të Byrosë ndaj kompanive të sigurimit është 445 mijë Euro (2016: 394 mijë Euro). Bazuar në procedurat tona të kryera më 31 Dhjetor 2017 janë konfirmuar përmes konfirmimeve me shkrim të drejtpërdrejtë, në vlerë prej 1,453 mijë Euro si të arkëtueshme nga Byroja. Si rezultat, ne nuk ishim në gjendje të siguronim siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë e detyrimeve ndaj kompanive të sigurimit të njohura më 31 Dhjetor 2017.
- Më 31 Dhjetor 2017 vlera për rastet gjyqësore nga paditë e ngritura kundër Byrosë nga kompanitë e sigurimeve (Sigkos, Insig dhe Dukagjini) arrin vlerën 1,736 mijë Euro si dhe paditë nga punëtorët dhe ish punëtorët e cila na është raportuar arrin vlerën prej 505 mijë Euro në total 2,242 mijë Euro. Duke zbatuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit nuk ishim në gjendje të sigurojmë siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme në lidhje me saktësinë dhe tërësinë e informacionit që kemi marrë lidhur me rastet gjyqësore të ngritura kundër Byrosë. Si rezultat, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund të jetë i nevojshëm për pasqyrat financiare të Byrosë më dhe për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2017, për humbjet e mundshme nga rastet gjyqësore.
- Siç është shpalosur në Shënimin 17 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i detyrimeve të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve më 31 Dhjetor 2016 është 19,717 mijë Euro. Gjatë vitit 2016 Byroja ka bërë ndryshime në bazën e të dhënavë të dëmeve të raportuara por jo të zgjidhura (RBNS) lidhur me periudhat para vitit 2016, efekti i të cilave ndryshime është pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2016. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullimet në bilancin fillestar të këtyre detyrimeve sipas 1 Janar 2016 si dhe për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve të njohura gjatë vitit që mbaron më 31 dhjetor 2016.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombe të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tonë sipas këtyre standardeve janë pëershkuar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Byroja në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Çështjet tjera

Pasqyrat financiare për vitin të ka përfunduar më 31 Dhjetor 2016 janë audituar nga një auditor tjetër, raporti është lëshuar me datën 13 Prill 2017 duke e kualifikuar raportin e auditorit për detyrimet tjera nga kompanitë e sigurimit, rastet gjyqësore dhe detyrimeve të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombe të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, dhe për kontrolllet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së Byrosë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përvèç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Byronë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përvèç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesin e raportimit financiar të Byrosë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tonë janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontolleve të brendshëm të Byrosë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojm mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Byrosë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të térheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tillë janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që Byroja të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C.

23 Shkurt 2018

Rr. Pashko Vasa, Nr.46
10 000 Prishtinë, Kosovë



BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Të hyrat			
Të hyrat nga primet e sigurimeve	6	8,604	8,269
Primet e ceduara për risigurues / primet e risigurimit	7	(93)	(100)
Primet e shkruara neto		8,511	8,169
Ndryshimet në rezervat e primeve të pafituar	18	16	(26)
Primi i fituar neto		8,527	8,143
 Të hyrat tjera			
Të hyrat nga ndryshimet në të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezervat teknike	16	(4,467)	1,015
Gjithsej të hyrat		8,421	13,247
 Shpenzimet e humbjes dhe të rregullimit	17	(1,102)	(6,175)
Kostot e marrjes në sigurim	9	(5,924)	(5,121)
Shpenzimet administrative	10	(1,395)	(1,951)
Gjithsej humbja dhe shpenzimet		(8,421)	(13,247)
Teprica/(Mungesa) për vit		-	-
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
 Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse		-	-

Shënimet shoqëruarë nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT
Pasqyra e pozicionit finansiar
Më 31 Dhjetor 2017

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
ASSETET QARKULLUESE			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	11	1,660	1,642
Të arkëtueshmet	12	590	642
Pajisjet	13	84	112
Pasuritë e paprekshme	14	22	42
Kosto e shtyrë e përvetësimit	15	38	45
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezervat teknike	16	15,250	19,717
Të arkëtueshmet ndaj kompanive të sigurimit për tepricat e akumuluara	20	42	-
TOTALI I PASURIVE		17,686	22,200
DETÝRIMET			
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	17	15,250	19,717
Rezervat e primit të pafituar	18	460	476
Detyrime të tjera	19	1,976	1,911
Të pagueshmet ndaj kompanive të sigurimit për tepricat e akumuluara	20	-	96
TOTALI I DETÝRIMEVE		17,686	22,200
BALANCA E FONDEVE			
TOTALI I DETÝRIMEVE DHE BALANCA E FONDEVE		17,686	22,200

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Administrativ i Byrosë më 23 Shkurt 2018
dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Blerim Pushkoli
Drejtor Ekzekutiv

Fadil Veseli
UD Drejtoret Financiar

Shënimet shoqërueshë nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT
Pasqyra e ndryshimeve në fonde
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

BALANCA E FONDIT
(në 000 EUR)

Bilanci më 1 Janar 2016

Transaksionet me pronarët

Teprica/(Mungesa) për vitin

Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse

Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse

Bilanci më 31 Dhjetor 2016

Bilanci më 1 Janar 2017

Transaksionet me pronarët

Teprica/(Mungesa) për vitin

Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse

Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse

Bilanci më 31 Dhjetor 2017

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016
	(në 000 EUR)	(në 000 EUR)	
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative Teprica/(Mungesa) për vitin			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10	75	87
Ndryshimi në të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike	16	4,467	(1,015)
Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit	15	7	(9)
Ndryshimi në të arkëtueshmet	12	51	(397)
Ndryshimi në rezervat e pafituara të primeve	18	(17)	26
Ndryshimi në detyrimet e sigurimeve për humbjet dhe shpenzimet e humbjeve nga rregullimet	17	(4,467)	1,015
Ndryshimet në detyrime të tjera dhe të pagueshme ndaj kompanive të sigurimit për tepricën e akumuluar	20	(70)	190
Paraja neto e gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet operative		46	(103)
 Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve dhe pašurive të patrupëzuara	13	(28)	(20)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(28)	(20)
 Neto rritja në para dhe ekuivalentë të parasë		18	(123)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 1 janar		142	265
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	11	160	142

Shënimet shoqëruuese nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe të gjitha kompanitë e sigurimeve të Republikës së Kosovës kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve ("BKS" apo "Byroja"). Në pajtim me Ligjin, BKS ka marrë përsipër të gjitha operacionet nga Shoqatat e Sigurimeve të Kosovës të mëparshme dhe Fondi i Garancisë nga 1 janar 2012, së bashku me të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tyre.

Byroja është themeluar me qëllim për të siguruar përputhshmërinë me të gjitha detyrimet që rrjedhin nga sistemi Ndërkombëtar i kartës së Sigurimit.

Në veprimtarinë e saj Byroja:

- Përfaqëson anëtarët në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në fushën e Sigurimeve të Detyrueshme nga Auto përgjegjësia
- Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore lidhur me Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia
- Furnizon anëtarët me Certifikata Ndërkombëtare të Sigurimit (Karton të Gjelbër) sipas formatit te përcaktuar nga Këshilli i Byrove,
- Siguron kryerjen e detyrave në lidhje me anëtarësimin e saj në Këshillin e Byrove
- Ratifikon marrëveshje me Byrotë homologe
- Kryen funksione të Byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit në përputhje me dispozitat e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove dhe marrëveshjet suplementare;
- Bashkëpunon me organet shtetërore për çështjet që kanë të bëjnë me Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia,
- Administron Fondin Garantues të Kartonit të Gjelbër, Fondin e Kompensimit dhe Policën e Sigurimit Kufitar
- Menaxhon Fondin e Kompensimit me qëllim të pagesës së dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës në raste si:
 - a) Dëmshpërbimi nga përdorimi i mjitet motorik të pasiguruar,
 - b) Dëmshpërbimi nga mjeti motorik i pasiguruar me regjistrim të huaj,
 - c) Dëmshpërbimi nga përdorimi i mjeteve të paidentifikuara,
 - d) Dëmshpërbimi në rast të likuidimit apo falimentimit të siguruesit dhe
 - e) Dëmshpërbimi bazuar në sigurimin kufitar
- Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar të kontribuojnë çdo tre (3) muaj financierisht në fondin e kompensimit, në përpjesët im të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin paraardhës.

Policat e sigurimit shiten në çdo pikë kufitare në Kosovë. Të gjitha primet bruto të grumbulluara janë shpërndarë te të gjitha kompanitë e licencuara të sigurimit që veprojnë në Kosovë, pas mbulimit të shpenzimeve operative dhe pagesës së dëmeve të Byrosë. TVSH-ja dhe tatimi në premitë bruto të lëshuara është shpërndarë nga Byroja tek kompanitë e sigurimeve të cilët janë përfundimisht përgjegjëse për të paguar TVSH-në dhe tatimin mbi preminë e llogaritur në 16% (18% nga Shtator 2015) dhe respektivisht 5%.

2 POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël kryesore të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë detajuar si më poshtë

2.1 Bazat e përgatitjes dhe pasqyra e përputhshmërisë

Byroja përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të aplikueshme për kompanitë e sigurimit ("Rregullat e BQK-së"), dhe në veçanti, në bazë të vendimit ligor përkatës që përcakton zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur më dhe për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Të dhënët aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe. Nëse është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e paraqitura për vitin aktual.

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

(a) Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet në fuqi nga 1 Janari 2017

Një numër i standardeve të reja që janë lëshuar nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, interpretime dhe amendamente të lëshuara nga Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) kanë hyrë në fuqi për periudhën që fillon nga (ose pas) 1 Janar 2017.

Shënim: jo të gjitha standardet dhe interpretimet e reja që kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhën nga (ose pas) 1 Janar 2017 kanë efekt në pasqyrat financiare të Byrosë.

SNK 8:28 - Efekti i zbatimit filletar të SNRF-së në politikat kontabël të Byrosë.

Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë nga (ose pas) 1 Janar 2017 :

- Vlerësimi vjetor i ciklit të SNRF 2014-2016 (Ndryshimet në SNRF 12 Shpalosja e Interesit në njësitë e tjera);
- SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat (Amendmentet - Njohja e Pasurive Tatimore të Shtyra në Humbjet e Parealizuara)
- SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë (Amendmentet në Iniciativat e Shpalosjeve).

Qëllimi i SNRF 12 është sqaruar për të bërë të qartë se kërkosat për dhënien e informacioneve shpjeguese në këtë standard, përveç atyre në paragrafët B10 - B16, zbatohen përi interesa pavarësisht nëse ato klasifikohen si të mbajtura për shitje, siç mbahet përi t'u shpërndarë pronarëve ose si operacionet e ndërpresa në përputhje me SNRF 5.

Ndryshimi në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat qarteson kontabilizimin përi pasuritë tatimit të shtyrë në lidhje me instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë, por që nuk konsiderohen të zhvlerësuara (për shembull, një investim në një normë fiksë obligacioni ku vlera e drejtë ka rënë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, por aseti nuk konsiderohet të jetë zhvlerësuar në vlerë). Në mënyrë të veçantë sqaron se tatimet e shtyra duhet të njihen sipas diferencave të përkohshme të zbritshëm që rrjedhin nga humbjet e parealizuara në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëse janë përbushur të gjitha kriteret e njohjes përi tatimet e shtyra, dhe pavarësisht nëse është planifikuar të rikuperojë instrumentin nëpërmjet shitjes së tij deri në maturim.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet(vazhdim)**

Amendamenti i SNK 7 synon të përmirësojë informacionin në lidhje me ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit. Një mënyrë për të siguruar këtë shpalosje do të ishte të sigurojë një koordinim të vlerave kontabël të hapjes dhe mbylljes për çdo zë për të cilin flukset e mjeteve monetare kanë qenë ose do të klasifikohen si aktivitete financiare. Koordinimi do të përfshinte:

- Ndryshimet nga financimi i rrjedhës së parasë;
- Ndryshimet që rrjedhin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera;
- Shkëmbimet tjera jo-monetare (p.sh. ndryshimet në kurset e këmbimit valutor, qiraja e re financiare dhe ndryshimet në vlerën e drejtë);

Nuk ka pasur standarde dhe interpretime të reja efektive për herë të parë për periudhat që fillojnë nga (ose pas) 1 Janarit 2017 dhe që kanë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare.

(b) Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas vitit që mbaron më 31 Dhjetor 2017

Ekzistojnë një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Byroja ka vendosur të mos i miratojë në fillim. Më të rëndësishmet nga këto janë:

- SNRF 9 Instrumentet Financiare (efektive për periudhat duke filluar nga (ose pas) 1 Janarit 2018); dhe
- SNRF 16 Qiratë (efektive për periudhat duke filluar nga (ose pas) 1 Janarit 2019).

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Byroja ka identifikuar se miratim i SNRF 9, i cili zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare:

Byroja do të duhet të aplikojë nga 1 Janari 2018 një model të pritshëm të humbjes së kredisë gjatë llogaritjes së humbjeve nga zhvlerësimi në të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshmet e tjera (të tanishme dhe jo-aktuale). Kjo do të rezultojë në rritje të provizioneve të dëmtuara dhe në një gjykim më të madh për shkak të nevojës për të analizuar informacionin e kërkuar kur vlerësohet shuma e duhur e provizioneve. Gjatë zbatimit të SNRF 9, Byroja duhet të marrë në konsideratë probabilitetin e një mospagimi që ndodh gjatë jetës kontraktuale të llogarive të arkëtueshme dhe kontratat e bilancit të aseteve sipas njohjes fillestare të këtyre aseteve.

SNRF 16 Qiratë

Aprovimi i SNRF 16 do të rezultojë në Byro në njohjen e drejtë të aseteve dhe detyrimeve të qirasë për të gjitha kontratat që janë, ose përfshijnë, një konratë qiraje. Për qiratë aktualisht të klasifikuara si qira operacionale, sipas kërkësave të tanishme të kontabilitetit Byroja nuk i njeh asetet ose detyrimet përkatëse, dhe në vend të kësaj i ndan pagesat e qirasë në mënyrë të drejtë mënyrë sipas afatit të qirasë, duke shpalosur në pasqyrat financiare vjetore detyrimin total financier.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet(vazhdim)****Të tjera**

Byroja nuk pret ndonjë standard tjetër të nxjerrë nga BSNK, dhe jo efektiv, që të ketë ndonjë ndikim material në Byro.

Më poshtë gjeni një listë e standardeve të reja dhe të ndryshuara të cilat, në kohën e shkrimit, ishin lëshuar nga BSNK, por që janë efektive në periudhat e ardhshme. Vlera e detajeve të matura dhe cilësore që do të jepen për se cilën prej standardeve, ashtu si shuma e detajeve që duhet dhënë për SNRF 9, 15 dhe 16, varen nga rrethanat e se cilës Byro.

- KIRFN Interpretimi 22 Transaksionet në Valutë të Huaj dhe Trajtimi Paraprak (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNRF 2 Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve për Pagesat e Bazuara në Aksione (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNK 40: Transferimet e Investimeve të Pronës (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Vlerësimi vjetor i ciklevës të Standardeve të SNRF-ve 2014-2016 që kanë të bëjnë me çështjet në SNRF 1 Adaptimet e para në SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Kompanitë e Përbashkëta (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019);
- Tiparet e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshime në SNRF 9), (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019)
- Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Kompanitë e Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28) (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2021);

2.3 Valuta funksionale dhe ajo e prezantimit

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare janë matur duke përdorur valutën e hapësirës primare ekonomike në të cilën operon Byroja ("monedha funksionale"). Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Euro, që është valuta funksionale dhe e prezantimit të Byrosë.

2.4 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e valutave të huaja përkthehen në valutën funksionale duke përdorur normat ekzistuese të këmbimit në datën e transaksioneve. Fitimet ose humbjet nga këmbimi që rezultojnë nga vendosja e transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi i fund vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare të nominuara në valuta të huaja njihen në fitim ose humbje.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve (referohu në Shënimin 3).

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjera të ndryshëm që besohet të janë të arsyeshëm në rrethanat, rezultatet e të cilave formojnë bazën e gjykimeve për vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshëm nga burimet tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet themelore janë rishikuar në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhën në të cilën janë rishikuar, nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e inspektimit dhe periudhat e ardhshme, nëse inspektimi ndikon periudhat e tanishme dhe të ardhshme.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet mbahen në koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kosto historike përfshinë të gjitha shpenzimet që i takojnë drejtë për së drejti blerjes së artikujve.

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerat bartëse të pasurive ose njihen si pasuri i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur është e mundur që benifitet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikuj do të rrjedhin të Byroja dhe kur kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

Zhvlerësimi i pronës dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre të vlerave të mbeturës përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar, si në vazhdim:

Pajisjet	20%
Mobilet	20%
Automjetet	20%
Investimet në objektet e marra me qira	10%

Vlera e mbetur e pasurive rivlerësohet dhe korrigohet sipas nevojës, rregullohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Pasuritë që janë subjekt i zhvlerësimit rishikohen për dëmtimet kurdo që ngjarjet apo ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera e bartur nuk është e rikuperueshme. Vlera e bartur e pasurive në të shlyhet menjëherë në vlerën e rikuperueshme nëse vlera e pasurisë është më e madhe sesa vlera e vlerësuar e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është më e madhja e vlerës së drejtë të pasurisë minus kostot për të shitur dhe vlerës në përdorim. Fitimet dhe humbjet nga heqja prej përdorimit përcaktohen duke krahasuar të hyrat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

2.7 Pasuritë e patrupëzuara

Softueri kompjuterik

Kostot që lidhen drejtpërdrejt me produkte softuerike të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga Byroja që ndoshta do të gjenerojnë përfitime ekonomike dhe që tejkalojnë shpenzimet përtëj një viti, njihen si pasuri jo-materiale (patrupëzuara). Kostot e zhvillimit të softuerit kompjuterik janë njojur si pasuri dhe janë amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë një periudhe prej pesë vjetësh. Shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e programeve kompjuterike njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

2.8 Instrumentet Financiare

Byroja i klasifikon investimet e veta në kategoritë si në vazhdim: pasuritë financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, hua dhe të arkëtueshmet, pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim dhe pasuritë financiare të gatshme për shitje. Klasifikimi varet në qëllimin për të cilin janë siguruar investimet. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve gjatë njojjes fillestare dhe e rivlerëson këtë në secilën datë raportuese.

(a) Pasuritë financiare në vlerë reale përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregti dhe ato të caktuara në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes që në fillim. Një pasuri financiar është klasifikuar në kategorinë "pasuritë financiare në vlerë reale përmes fitimit" që në fillim nëse është siguruar fillimisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, nëse bënë pjesë në portofolion e pasurive financiare ku ka déshmi për marrje të profitit në afat të shkurtër, ose nëse është përcaktuar në mënyrë të tillë nga menaxhmenti. Byroja nuk ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.8 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(b) Hua dhe të arkëtueshmet

Hua dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv ndryshe prej atyre që Byroja synon të shesë në afat të shkurtër ose që i ka përcaktuar në vlerën reale përmes të hyrave apo të gatshmeve për shitje. Hua dhe të arkëtueshmet njihen fillimiqtë në vlerën reale dhe më pas vlerësohen në kosto të amortizimit duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizioni për démtim. Provizioni për démtim të huave dhe të arkëtueshmeve përcaktohet kur ka dëshmi objektive se Byroja nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas afateve të tyre origjinale. Të arkëtueshmet që dalin nga kontratat e sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për démtim si pjesë të rishikimit të démtimit të huave dhe të arkëtueshmeve.

(c) Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuritë financiare jo derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe me maturim fiks ndryshe prej atyre që plotësojnë definicionin e huave dhe të arkëtueshmeve për të cilat menaxhmenti i Byrosë ka synimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim. Këto pasuri njihen fillimiqtë në vlerë reale dhe më pas vlerësohen në kosto të amortizimit duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizioni për démtim. Provizioni për démtim i pasurive të mbajtura deri në maturitet përcaktohet kur ka dëshmi objektive se Byroja nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas afateve të tyre origjinale. Byroja nuk ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori në datën pasqyrës së pozicionit financiar.

(d) Pasuritë financiare të gatshme për shitje

Pasuritë financiare të gatshme për shitje janë pasuritë financiare jo-derivative që përcaktohen në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në ndonjë kategori tjeter. Byroja nuk ka pasuri financiare të klasifikuara në këtë kategori në datën pasqyrës së pozicionit financiar.

Njohja fillestare

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit - datë në të cilën Byroja zotohet për të blerë apo shitur pasurinë. Pasuritë financiare fillimiqtë njihen në vlerë reale plus, në rast të pasurive financiare që nuk janë të bartura në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që janë direkt të atribueshme në përvetësimin e tyre. Pasuritë financiare të bartura në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes fillimiqtë njihen në vlerën e tyre reale, dhe kostot e transaksioneve regjistrohen si shpenzim në fitim apo humbje.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat për të pranuar fluks të parasë nga to kanë skaduar ose kur ato janë transferuar dhe gjithashtu Byroja ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Matjet pasuese

Pasuritë financiare të gatshme për shitje dhe pasuritë financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes më pas barten në vlerën reale. Hua dhe të arkëtueshmet si dhe pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim barten në kosto të amortizimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara që dalin nga ndryshimet në vlerën reale të kategorisë së "pasurive financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes" përfshihen në fitim apo humbje në periudhën në të cilën kanë ndodhë. Fitimet dhe humbjet e parealizuara që pasojnë nga ndryshimet në vlerën reale të pasurive financiare jo-monetare të klasifikuara si të gatshme për shitje, njihen në ekuitet. Kur mjetet financiare të klasifikuara si të gatshme për shitje shiten apo dëmtohen, rregullimet e akumuluara të vlerës reale përfshihen në fitim apo humbje si neto fitime/humbje në pasuritë financiare.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.8 Instrumentet Financiare (vazhdim)

Matjet Pasuese

Fitimet dhe humbjet që dalin nga ndryshimet në vlerë reale të kategorisë së ‘pasurive financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes’ njihen në fitim apo humbje brenda neto fitimeve të vlerës reale mbi pasuritë financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes përgjatë periudhës në të cilën kanë dalë. Ndryshimet në vlerë reale të letrave me vlerë monetare dhe jo-monetare të klasifikuara si të gatshme për shitje njihen në ekuitet. Interesi mbi letrat me vlerë të gatshme për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në fitim apo humbje. Dividendët mbi instrumentet e ekuitetit të gatshëm për shitje njihen në fitim apo humbje atëherë kur është e vendosur drejta e Byrosë për të pranuar pagesat. Që të dy përfshihen në linjën e të hyrave të investimit.

Vlerat reale të investimeve të kuotuara bazohen në çmimet aktuale të ofertimit. Nëse tregu për një pasuri financiar nuk është aktiv, Byroja vendoșon vlerën reale dukë përdorur teknikat e vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve duarsh lira, duke u referuar në instrumentet e tjera që kryesisht janë të njëjtë, në analizat e diskontit të rrjedhës të parasë etj.

2.9 Humbjet nga dëmtimet

Pasuritë financiare të bartura në kosto të amortizimit

Byroja e vlerëson në secilën datë të pozicionit financiar nëse ka dëshmi objektive se një aset apo tërësi e pasurive financiare ka humbur vlerë. Një pasuri apo tërësi e pasurive financiare humbet vlerë dhe humbjet e dëmtimit ndodhin vetëm nëse ka dëshmi objektive të dëmtimit si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë (një ngjarje e humbjes) dhe se ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) kanë ndikim i cili mund të matet besueshëm në rrjedhën e parasë së vlerësuar për të ardhmen e pasurisë financiare apo grup të pasurive financiare.

Dëshmia objektive se një pasuri financiar apo grup i pasurive dëmtohet, përfshin të dhënat e dallueshme që tërheqin vëmendjen e Byrosë mbi ngjarjet në vazhdim:

- a Vështirësi e dukshme financiare e emetuesit apo debitorit;
- b Shkelja e kontratës, si mos pagesa apo vonesa e pagesave;
- c Është e mundur që emetuesi apo debitori do të hyjë në bankrotim apo riorganizim tjetër financiar;
- d Ndryshimet e pafavorshme në statusin e pagesave të emetuesit apo debitorit, apo
- e Të dhënat e dukshme që tregojnë se ka zvogëlim të dukshëm në parashikimin e ardhshëm të rrjedhës së parasë prej një grupei të pasurive financiare që nga njohja fillestare e këtyre pasurive, megjithëse zvogëlimi nuk mund të identifikohet akoma në pasuritë individuale në Byro, duke përfshirë:
 - Ndryshime jo të favorshme në statusin e pagesës të emetuesit ose borxhliut në grup; ose
 - Kushte ekonomike shtetërore ose vendore që ndërlidhen me problemet në pasuritë e gruپit.

Byroja fillimisht vlerëson nëse dëshmia objektive mbi dëmtimin ekziston veçmas për pasuritë financiare që janë individualisht të rëndësishme. Nëse Byroja përcakton se nuk ekziston dëshmi objektive për dëmtim të pasurisë për pasurinë financiare të vlerësuar ndaras, pa marrë parasysh nëse është i rëndësishëm apo jo, përfshin pasurinë në grup të pasurive financiare me karakteristika të ngjashme të riskut kreditor dhe kolektivisht i vlerëson për dëmtim. Pasuritë që janë të vlerësuara ndarazi për dëmtim dhe për të cilat një humbje e dëmit është njohur apo vazhdon të njihet, nuk janë përfshirë në vlerësimin kolektiv të dëmtimit.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.9 Humbjet nga dëmtimet (vazhdim)

Nëse ka dëshmi objektive se ka ndodhur një humbje dëmtimi mbi kreditë dhe të arkëtueshmet apo investimet e mbajtura deri në maturim të bartura në kostot të amortizuar, shuma e humbjes është matur si ndryshim ndërmjet vlerës bartëse të pasurive dhe vlerës aktuale të rrjedhave të vlerësuara të parasë në të ardhmen (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kreditit që kanë ndodhur) të zbritura në normën originale dhe efektive të interesit të pasurisë financiare. Vlera bartëse e pasurive është reduktuar përmes përdorimit të llogarisë për lejim, dhe shuma e humbjes është njojur në fitim apo humbje. Nëse një investim i mbajtur deri në maturim apo hua ka normë variabile të interesit, norma diskontuese për matjen e ndonjë humbje të dëmtimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar nën kontratë. Për të qenë më praktik, Byroja mund të masë dëmtimin në bazë të vlerës reale të një instrumenti duke përdorur çmimin e dukshëm të tregut.

Për qëllimin e vlerësimit kolektiv të dëmtimit, pasuritë financiare janë grupuar në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor (p.sh. në bazë të procesit të kategorizimit që merr në konsideratë llojin e pasurisë, industrinë, vendndodhjen gjeografike, statutin e vonesave në pagesë dhe faktorë të tjerë relevant). Këto karakteristika janë relevante për vlerësimin e rrjedhave të ardhshme të parasë për grupet e pasurive të tilla duke qenë indikatorë në aftësinë e emetuesit për të paguar shumat e duhura nën afatet e kontraktuara të instrumentit të borxhit të vlerësuar.

Nëse në një periudhë pasuese, shuma e humbjes së dëmtimit ulet dhe kjo ulje mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pas njoħjes së dëmtimit (siç mund të jetë norma e përmirësuar e kreditit), atëherë humbja e dëmtimit e njoħur paraprakisht është kthyer duke rregulluar konton për lejim. Shuma e kthimit është njoħur në fitim ose humbje

Pasuritë financiare të bartura në vlerën reale

Byroja vlerëson në secilën datë të pasqyrës së pozitës financiare nëse ka dëshmi objektive se një pasuri finanziar i gatshëm për shitje është dëmtuar, duke përfshirë edhe rastin e investimeve të ekuitetit të klasikuara si të gatshme për shitje, një ulje e rëndësishme apo e tej zgjatur e vlerës reale të letrës me vlerë nën kosto të saj. Nëse një dëshmi e tillë ekziston për pasuritë financiare të gatshme për shitje, humbja kumulative - e matur si diferençë ndërmjet kostos së përvetësimit dhe vlerës reale aktuale, minus ndonjë humbje e dëmtimit mbi pasurinë financiare të njoħur më parë në fitim apo humbje - është hequr nga ekuiteti dhe është njoħur në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet e dëmtimit të njoħura në pasqyrën e të ardhurave në instrumentet e ekuitetit nuk janë kthyer më pas. Humbja e dëmit është kthyer përmes pasqyrës së të ardhurave, nëse në një periudhë pasuese vlere reale e një instrumenti të borxhit të klasikuara si i gatshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarjen që ndodh pasi që humbja e dëmtimit është njoħur në fitim ose humbje.

Dëmtimi i pasurive të paprekshme

Pasuritë e paprekshme që kanë një kohë të pa definuar të përdorimit, nuk janë subjekte të amortizimit dhe testohen çdo vit për dëmtim. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit rishikohen për dëm kurdo që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Një humbje e dëmtimit njihet për shumën me të cilën vlera bartëse e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme të saj. Vlera e rikuperimit është më e larta e vlerës bartëse të pasurive minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim. Për qëllimet e vlerësimit të dëmtimit, pasuritë grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka rrjedha të parasë që janë të identifikueshme veçmas (njësitë e gjenerimit të parasë).

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Njohja e të ardhurave

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Të pagueshmet e sigurimit llogariten veçmas për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga premiumi kontingjent (pafituar), rreziku kontingjent (i pa skaduar) dhe humbja kontingjente (të papaguara në datën e mbylljes së vtitit financiar). Të pagueshmet e sigurimeve (provizonet) paraqesin vlerësimet e pagesave në të ardhmen për dëmet e raportuara dhe të pa raportuara. Byroja nuk zurretë të pagueshmet e sigurimeve. Çdo ndryshim në vlerësimet pasqyrohet në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i të pagueshmeve të sigurimit është një proces kompleks që ka të bëjë me pasiguri, që kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara.

Të hyrat

Bruto primet e shkruara regjistrohen në pranimin e pagesave të primit dhe janë transferuar në fitim në bazë pro-rata për një afat të mbulimit të policës. Bruto primet e shkruara reflektojnë shkrimet e biznesit gjatë vtitit. Primet fitohen nga data e lidhjes së rrezikut, gjatë periudhës së dëmshpërblimit, bazuar në modelin e rreziqeve të lëshuara.

Primet e pafituara

Provizioni për primet e pafituara përbën proporcionin e bruto primit të shkruar që vlerësohet të fitohet në vitet financiare pasuese, kalkulari veçmas për secilën kontratë duke përdorur metodën pro-rata-ditore, të përmirësuar nëse e nevojshme për të reflektuar ndonjë variacion në rreziqet e incidenteve gjatë periudhës të mbuluar me kontratë.

Rezerva për primin e pafituar përfshin primet e pranuara për rreziqet që nuk kanë skaduar ende. Në përgjithësi rezerva është lëshuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe është e njojur si të ardhura nga premiumi.

2.11 Klasifikimi i Produkteve

Kontratat e sigurimit janë ato kontrata kur Byroja (siguruesi) ka pranuar risk të rëndësishëm të sigurimit nga pala tjetër (i siguruari) duke u akorduar të kompensoj police mbajtësit nëse një ngjarje e specifikuar e pasigurt (ngjarje e sigruar) ka ndikim të kundër në siguruesin. Si direktivë e përgjithshme, Byroja përcakton nëse ka risk të rëndësishëm të sigurimit, duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitimet e pagueshme nëse ngjarje e sigruar nuk ka ndodhur. Kontratat e sigurimit gjithashtu mund të transferojnë risk financiar.

Pasi që kontrata është kualifikuar si kontratë e sigurimit, ajo mbetet një kontratë e sigurimit për pjesën tjetër të jetës, edhe nëse rishku i sigurimit zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, vetëm nëse të gjitha të drejtat dhe obligimet janë shuar.

2.12 Detyrimet e kontratave të sigurimit dhe kosto e shtyrë e përvetësimit

Dëmet (rregullimet e humbjeve)

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e shlyerjes dhe trajtimin e dëmeve të paguara dhe të papaguar që rrjedhin nga ngjarjet që ndodhin gjatë vtitit financiar së bashku me rregullimet e provisionimit të dëmeve të viteve paraprake. Dëmet pezull përbëjnë provisionimin për vlerësimin e Byrosë së kostos përfundimtare të zgjidhjes së të gjitha dëmet e ndodhura por të papaguara në datën e raportimit të Pozicionit financiar nëse janë raportuar apo jo, dhe shpenzimeve të trajtimit të dëmeve që lidhen me rregullimet të brendshme dhe të jashtme dhe një diferencë e kujdeshme. Dëmet e papaguara janë vlerësuar nga shqyrtimi i ankesave individuale dhe duke e bërë lejim për dëmet e shkaktuara, por nuk janë raportuar ende, efekti i ngjarjeve të të dyjave të brendshme dhe të jashtme të parashikueshme, të tillë si ndryshimet në procedurat e trajtimit të ankesave, inflacion, trendët gjyqësore, ndryshime legislative dhe përvojën e kaluar dhe trendët.

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Detyrimet e kontratave të sigurimit dhe kosto e shtyrë e përvetësimit (vazhdim)

Provizonet për dëmet e pazgjidhura nuk janë zbritur. Rregullimet për provisionimet e dëmeve të përcaktuara në vitet e mëparshme janë të reflektuara në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën janë bërë rregullime dhe të shpalosen veçmas nëse janë materiale.

Përderisa Këshilli Administrativ konstaton se detyrimet e sigurimeve për dëmet dhe rikuperimet e lidhura me risigurimin janë deklaruar në mënyrë të drejtë, përgjegjësia përfundimtare mund të ndryshojë si pasojë e informacionit të mëvonshëm dhe ngjarjet dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme në shumat e ofruara. Përshtatjet në shumat e pasiveve të sigurimit janë reflektuar në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën janë bërë.

Kontingjentet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e dëmeve janë në proces gjyqësor, dhe për të cilat Byroja ka regjistruar detyrime të përshtatshme të sigurimit.

Risigurimi

Byroja lëshon primet e sigurimit dhe rrezikut në rrjedhë normale të biznesit, në mënyrë që të kufizoj humbjet e mundshme. Risigurimi regjistrohet bruto në Pasqyrën e pozicionit financier. Pasuritë e risigurimit përfshijnë balancat e detyrimeve nga kompanitë e risigurimit në të dyja në humbjet e paguara dhe të papaguara si dhe në shpenzimet e rregullimeve të humbjes, por nuk përfshijnë lëshimin e primeve të pafitaura. Byroja llogarit primet e lëshuara bazuar në bruto primet e shkruara dhe shpenzon primet që rezultojnë menjëherë. Asnjë pasuri i risigurimit nuk regjistrohet për primet e lëshuara të pafitaura. Shumat e rikuperueshme nga risigurimet vlerësohen në mënyrë të qëndrueshme me detyrimin e dëmeve të lidhura me politikat e risigurimit.

Kostot e shtyra të përvetësimit

Kostot e përvetësimit përcaktohen si kosto që rrjedhin nga përvetësimi i kontratave të sigurimit të tillë si komisionet e agjentëve, printimi i policave dhe tatimi i primit.

Përvetësimet direkte janë shtyrë sipas kushteve të policave në fuqi një metodë në përputhje me llogaritjen e provizioneve të primeve të pa përfititura. Kostot e shtyra të përvetësimit prezantohen si pasuri të ndara në Pasqyrën e pozicionit financier.

2.13 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë paraja dhe ekuivalentet të parasë përfshijnë llogaritë bankare që janë të liruara nga interesit. Paraja dhe ekuivalentet e parasë janë bartur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financier.

2.14 Tatimi

Byroja transferon tek kompanitë e sigurimit primet e shkruara bruto dhe kompanitë e sigurimit paguajnë tatim prej 5% në prime bruto dhe gjithashtu edhe TVSH. Primet që janë kthyer dhe rregullimet retroaktive të primit janë zbritur nga primet bruto për të arritur tek baza e tatimit. Byroja i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributete të sigurimit social.

2.15 Përfitimet e punëtorëve

Kontributet e detyruara të sigurimit social

Byroja nuk bën asnjë provisionim dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve mbi dhe për kontributet e paguara në planin pensional shtetëror, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**2.16 Provisionet**

Një provizion njihet kur Byroja ka obligim aktual si rezultat i një ngjarje në të kaluarën dhe është e mundur një rrjedhje e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike të cilat do të kerkohen për të shlyer obligimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit. Provisionet janë rishikuar në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiare dhe janë rregulluar për të reflektuar vlerësim më të mirë aktual. Aty ku efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provisionit është vlera aktuale e shpenzimit që pritet të kerkohet për të shlyer obligimin. Provisionet nuk janë njojur për humbje operative të së ardhmes.

2.17 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet operative janë njojur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të përdorimit të shërbimit, kur kanë ndodhur.

2.18 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen pos nëse mundësia e rrjedhjes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por, shpaloset kur është e mundshme një rrjedhë e fitimeve ekonomike.

Shuma e humbjes nga kushtëzimet njihet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, një detyrim i shkaktuar në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes të rezultuar mund të bëhet.

2.19 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga drejtoret e Byrosë, së bashku me entitetet të cilat ata i kontrollojnë, që mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhmentin e Byrosë. Duke pasur parasysh secilën marrëdhënie të mundshme me palët e treta, vëmendja është e drejtuar më përbërjen e marrëdhënieve, dhe jo thjesht në formën ligjore.

2.20 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet pas datës raportuese që sigurojnë informata shtesë në lidhje me pozicionin e Byrosë në datën e Pasqyrën së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese), janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënimet shpjeguese kur ato janë materiale.

3 SUPOZIME DHE VLERËSIME TË RËNDËSISHME KONTABËL

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Byrosë, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshme nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë bazuar në përvjën historike dhe faktorë të tjerë që janë konsideruar të janë relevantë. Rezultatet e vërteta mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit jo-jetë, vlerësimet duhet të bëhen si për kostot e pritura përfundimtare të dëmeve të raportuara në datën e pasqyrës së gjendjes financiare ashtu edhe për kostot e pritura përfundimtare të dëmeve të pësuara por ende të pa raportuara në datën e pasqyrës së gjendjes financiare (IBNR). Kostoja përfundimtare e dëmeve të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të teknikave standarde aktuale të projekzionit të dëmeve.

Supozimi kryesor nën këto teknika është që përvoja e zhvillimit të dëmeve në të kaluar e Byrosë mund të përdoret për të projektuar zhvillimin e dëmeve në të ardhmen dhe kështu kostot përfundimtare të dëmeve. Si të tilla, këto metoda hulumtojnë zhvillimin e humbjeve të paguara dhe të pësuara, kostot mesatare për dëm dhe numrin e dëmeve të bazuar në zhvillimet e vëzhguar të viteve të mëhershme dhe shkallët e pritura të humbjes. Historiku i zhvillimit të dëmeve është kryesisht i analizuar nga vitet rastësore, por mund të analizohet më tej me anë të hapësirave gjeografike, si edhe nga linjat e rëndësishme të biznesit dhe llojet e dëmeve. Gjykimi shësë kualitativ është përdorur për të vlerësuar se deri ku trendet e kaluara nuk mund të aplikohen për të ardhmen, në mënyrë që të arrihet në kostot përfundimtare të vlerësuar të dëmeve që paraqesin rezultatin e mundshëm nga një seri rezultatesh të mundshme, duke marrë në konsideratë të gjitha pasiguritë e përfshira.

Humbjet nga zhvlerësimi në të arkëtueshmet

Byroja rishikon të arkëtueshmet e saj të sigurimit dhe jo-sigurimit për të vlerësuar dëmtimin në bazë vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësim duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Byroja bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë te mbikëqyrur që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një debitor individuale. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit.

4 MENAXHIMI I RISKUT

Korniza qeverisëse

Objektivi kryesore i kuadrit të Byrosë mbi menaxhimin e riskut dhe atë finansiar është që të mbrojë Byronë nga ngjarjet që pengojnë arritjet e qëndrueshme të objektivave të performancës financiare, përfshirë dështimin e shfrytëzimit të mundësive. Menaxhmenti kyç njeh rëndësinë kritike të të pasurit një sistem të menaxhimit efikas dhe efektiv të riskut.

Këshilli Administrativ aprovon politikat e menaxhimit të riskut të Byrosë dhe takohet rregullisht për të aprovuar ndonjë kërkesë komerciale, rregullative apo organizative të këtyre politikave. Këto politika përcaktojnë identifikimin e riskut të Byrosë dhe interpretimin e tij, limitojnë strukturën që të sigurojnë kualitetin e duhur dhe shpërndarjen e pasurive, drejtojnë strategjinë e lëshimit dhe risigurimit drejt qëllimeve të përbashkëta të Byrosë, dhe specifikojnë kërkesat e raportimit.

Korniza rregullative

Aktiviteti i Byrosë është gjithashtu subjekt ndaj kërkesave rregullative përbrenda juridikSIONIT ku operon. Këto rregullore jo vetëm që përshkruajnë aprovimin dhe monitorimin e aktiviteteve, por gjithashtu vënë disa dispozita frenuese për të minimizuar riskun e mos pagesave dhe insolvencës në anën e Byrosë së sigurimeve për t'u ballafaquar me detyrimet e paparashikuara që mund të lindin.

Risku i sigurimit

Risku kryesor që Byroja ballafaqohet nën kontratat e sigurimit është që dëmet e tanishme dhe pagesat e fitimeve ose koordinimi prej kësaj ndryshon nga çka është pritur. Kjo është e ndikuar nga frekuenca e dëmeve, ashpërsia e dëmeve, fitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi pasues në dëme afatgjata. Për këtë arsyе objektivi i Byrosë është të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion të mbulojnë këto detyriime.

Ekspozimi i mësipërm është zbutur nga shumëlojshmëria dhe madhësia e portfolios së kontratave të sigurimit dhe sipërfaqja gjeografike. Ndryshueshmëria e riskut gjithashtu është përmirësuar nga një zgjedhje e kujdeshme dhe implementimi i strategjisë me udhëzime të shkruara, gjithashtu edhe përdorimi i marrëveshjeve të risigurimit.

Shumica e bizneseve të sigurimit të licencuara janë themeluar në bazë të marrëveshjeve mbi humbjet e tejkaluara. Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit janë llogaritur në mënyrë konsistente me provisionet e dëmeve të pazgjidhura dhe janë në pajtueshmëri me kontratat e risigurimit. Edhe pse Byroja ka marrëveshje të risigurimit, nuk është e liruar nga obligimet e saj direkte ndaj të siguruarve dhe për këtë arsyе ekziston ekspozimi i kreditit në lidhje me sigurimin e lëshuar, deri në masë që çdo risigurues nuk mund ti përmbush obligimet e supozuara në pajtueshmëri me risigurime të tillë

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017****4 MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)*****Analiza e maturitetit***

Tabelat më poshtë organizojnë pasuritë dhe detyrimet financiare të Byrosë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 në grupime relevante sipas maturitetit të bazuar në periudhën e mbetur nga data e Pasqyrës së pozicionit finansiar deri në datën e maturimit si vijon:

	31 dhjetor 2017	Deri në 6			
		muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja dhe ekuivalentet e saj		1,660	-	-	1,660
Të arkëtueshmet		590	-	-	590
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike		15,250	-	-	15,250
Gjithsej pasuritë financiare		17,500	-	-	17,500
 Detyrimet financiare					
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve		15,250	-	-	15,250
Detyrimet tjera		1,976	-	-	1,976
Të pagueshmet të kompanitë e sigurimit për tepricat e akumuluara		(42)	-	-	(42)
Gjithsej detyrimet financiare		17,184	-	-	17,184
Hapësira e maturitetit		316	-	-	316
	31 dhjetor 2016	Deri në 6			
		muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja dhe ekuivalentet e saj		1,642	-	-	1,642
Të arkëtueshmet		642	-	-	642
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike		19,717	-	-	19,717
Gjithsej pasuritë financiare		22,001	-	-	22,001
 Detyrimet financiare					
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve		19,717	-	-	19,717
Detyrimet tjera		1,911	-	-	1,911
Të pagueshmet te kompanitë e sigurimit për tepricat e akumuluara		96	-	-	96
Gjithsej detyrimet financiare		21,724	-	-	21,724
Hapësira e maturitetit		277	-	-	277

4 MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

Risku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Byrosë nëse një klient apo palë tjetër e instrumenteve financiare dështon në përmbushjen e obligimeve kontraktuale, dhe del kryesish në të arkëtueshmet e Byrosë nga Byroja e Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe parasë dhe ekuivalentet e parasë.

Byroja është e eksposuar ndaj rrezikut kreditor për pagesat e bëra të siguruesve bazuar në marrëveshjen me Byrotë në Shqipërisë dhe Maqedoni, sipas së cilës Byroja regjistron të arkëtueshmet nga Byroja përkatëse. Byroja ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë ndaj ndonjë palë të kundërt. Ekspozimi maksimal i Byrosë ndaj riskut të kredisë është përfaqësuar nga shuma bartëse e çdo pasurie financiar në pasqyrën e pozicionit

	2017	2016
<i>Klasifikimet e pasurive financiare - vlerat bartëse</i>		
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	1,660	1,642
Të arkëtueshmet	590	642
Gjithsej	2,250	2,284

Rreziku kreditor për paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet i ulët, pasi që palët janë banka me reputacion.

Risku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimi i pasurive që bartin interes të ndryshojë nga maturimi i detyrimeve të përdorura që bartin interes për të financuar këto pasuri. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar, pra tregon deri në çfarë mase kjo është e eksposuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Të ardhurat e Byrosë dhe rrjedha e parasë operative janë në thelb të pavarur nga ndryshimet në normat e interesit të tregut.

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare nuk bartin interes.

Risku nga kursi i këmbimit

Byroja nuk është e eksposuar ndaj rrezikut të monedhave të huaja meqenëse të gjitha transaksionet e sajë janë kryer në monedhën vendore

5 VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË

Vlera e drejtë paraqet shumën e cila do të pranohej nëse shitet një pasuri ose shuma që paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet menaxheriale sipas llojit të pasurive dhe detyrimit.

Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura sipas vlerës së drejtë në bilanc të gjendjes janë paraqitur në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki grupon pasuritë dhe detyrimet financiare në tri nivele që janë në bazë të një rëndësie nga të dhënat hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

Niveli 1: çmimet e kuotuara (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë dhe detyrimet identike ;

Niveli 2 : të dhënat tjera hyrëse, përvèç çmimeve të kuotuara, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për vëzhgimin e pasurive ose detyrimeve, direkt (d.m.th. si çmimet), ose në mënyrë të tërthortë (d.m.th. të bëra nga çmimet) dhe

Niveli 3 : të dhënat hyrëse mbi pasuritë ose detyrimet që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për vëzhgimin e tregut.

Deri në datën e raportimit, Byroja nuk ka instrumente financiare të matura me vlerën e drejtë.

Instrumentet financiare që nuk janë prezantuara në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmblehdh shumat bartëse dhe vlerat e drejta për ato pasuri dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financier në vlerën e tyre të drejtë (mijë Euro).

	Shëname	Hua dhe të arkëtueshmet	Shpenzime tjeta të amortizimit	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2017					
Pasuritë financiare					
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	11	1,660	-	1,660	1,660
Të arkëtueshmet	12	590	-	590	590
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezerva teknike	16	15,250	-	15,250	15,250
		17,500	-	17,500	17,500
Detyrimet financiare					
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	17		15,250	15,250	15,250
Detyrime të tjera	19		1,976	1,976	1,976
Të pagueshmet tek kompanitë e sigurimeve për tepricat e grumbulluara	20		(42)	(42)	(42)
			17,184	17,184	17,184

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

5 VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

	Shëним	Hua dhe të arkëtueshmet	Shpenzime tjera të amortizimit	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2016					
Pasuritë financiare					
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	11	1,642	-	1,642	1,642
Të arkëtueshmet	12	642	-	642	642
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezerva teknike	16	19,717	-	19,717	19,717
		22,001	-	22,001	22,001
Detyrimet financiare					
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	17	-	19,717	19,717	19,717
Detyrime të tjera	19	-	1,911	1,911	1,911
Të pagueshmet tek kompanitë e sigurimeve për tepricat e grumbulluara	20	-	96	96	96
		-	21,724	21,724	21,724

Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet barten në koston e amortizimit, minus provisionet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejtë i përgjigjet vlerës së tyre bartëse, shkaku i maturitetit të tyre të shkurtër.

Pasuritë tjera financiare

Vlera e drejtë e pasurive monetare që përfshinë paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet t'i afrohet vlerës së tyre bartëse për shkak të maturitetit të tyre prej më pak se 3 muaj.

Detyrimet tjera

Vlera bartëse e detyrimeve tjera i afrohet vlerës së tyre bartëse për shkak të maturitetit të tyre prej më pak se 3 muaj

6 TË HYRAT NGA PRIMET E SIGURIMEVE

Të hyrat nga primet e sigurimeve, të cilat për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 janë në vlerë prej 8,604 mijë Euro (2016: 8,269 mijë Euro) ndërlidhen me sigurimin e detyrueshëm për automjete motorike të palës së tretë në kufijtë e territorit të Kosovës për shoferët e automjeteve me regjistrome të huaja që nuk posedojnë një sigurim të tillë. Byroja është e autorizuar të mbledh këto të hyra në emër të të gjitha kompanive të sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") për të shitur polica të sigurimit përbrenda territorit të Kosovës. Bazuar në vendimin e marrë nga Banka Qendrore e Kosovës të datës 18 korrik 2015 primet e sigurimit kufitar janë ulur dhe tarifat e reja janë të vlefshme nga 01 korrik 2015.

Në pajtim me ligjin për përgjegjësi të sigurimit të detyrueshëm të auto përgjegjësisë dhe vendimeve të Këshillit Administrativ, të ardhurat nga primi i sigurimit alokohen si vijon:

- Kontributi për fondin e kartonit të gjelbër në normën 20% gjatë vitit 2012
- Kontributi ne dëmet e fondit të kompensimit dhe BKS-së
- Kontributi për shpenzimet administrative të BKS-së
- dhe balanca e mbetur shpërndahet tek kompanitë e sigurimit

7 PRIMET E CEDUARA TEK RISIGURUESIT

Për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, primet e transferuara tek risiguruesit janë respektivisht në vlerë prej 93 mijë Euro dhe 100 mijë Euro.

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2014 Byroja ka hyrë në një marrëveshje risigurimi me SIA Mai Reinsurance Brokers për tejkalim të humbjes së risigurimit për detyrime të palëve të treta motorike vendore. Kjo marrëveshje do të mbulojë fondin e kompensimit për shoferë të pasiguruar dhe politikat e detyrimeve të palëve të treta motorike transit.

8 TË ARDHURAT TJERA

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Të ardhura nga kompanitë e sigurimit për kontributet shtesë	3,324	3,641
Të ardhura nga organizata të shërbimeve të dëmeve	898	432
Primet që duhen mbuluar nga kompanitë e për shkak të deficitit të vitit (Shënim 20)	139	16
TOTALI	4,361	4,089

Të ardhurat nga kompanitë e sigurimeve për kontributet shtesë

Gjatë vitit 2016, Byroja ka filluar impletimin e kërkeseve për financimin e Fondit të kompensimit sipas nenin 32 paragrafi 2 të ligjit Nr. 04/L-018 si dhe nën 4 të Rregullores për Fondin e Kompenimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Bazuar në ligj, kërkohet që secili i siguaruar në fillim të kuartalit të tretë duhet të depozitojë në llogarinë e Fondit të Kompenimit shumën e përcaktuar sipas rregullores. Gjithsej shuma e njojur për vitin e përfunduar me 2017 është 3,324 mijë Euro.

Të ardhurat nga organizatat për shërbimin e dëmeve

Të ardhurat nga organizatat për shërbimin e dëmeve përfaqësojnë të ardhura nga Byroja nga palët tjera në Shqipëri dhe Maqedoni

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017****9 KOSTOT E MARRJES NË SIGURIM**

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Primet për kompanitë e sigurimit	5,103	4,237
Shpenzimet e personelit	724	779
Primet e rimbursuara tek kompanitë e sigurimit	54	60
Shpenzimet e printimit	37	33
Shpenzimet e qirasë	6	12
TOTALI	5,924	5,121

10 SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Shpenzimet e Personelit	609	755
Provizioni i të arkëtueshmeve nga CSO Albania	326	262
Shpenzimet e qirasë	140	140
Shpenzimet e zhvlerësimit	55	67
Furnizuesit e zyrës dhe shërbimet	52	43
Karburant dhe elektricitet	37	33
Tarifat e bankës	33	27
Mirëmbajtje	21	27
Amortizimi	20	20
Shpenzimet për garancinë bankare	19	17
Telefoni dhe Interneti	17	20
Udhëtim dhe transport	13	27
Shpenzimet e reprezentacionit	9	10
Shpenzimet e marketingut	8	16
Sigurimi shëndetësor	5	16
Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit Bonus Malus	-	221
Pagat e këshillit administrativ	-	121
Shpenzimet gjyqësore	-	106
Donacione	-	7
Trajnimi i punëtorëve	-	3
Licenca e koordinatorëve	-	2
Shpenzime tjera	31	11
TOTALI	1,395	1,951

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017****11 PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË**

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Paraja në bankë	107	107
Paraja e gatshme	53	35
	<hr/> <hr/> <hr/>	<hr/> <hr/> <hr/>
Mjetet e bllokuara për garancinë	1,500	1,500
	<hr/> <hr/> <hr/>	<hr/> <hr/> <hr/>
TOTALI	1,660	1,642

Mjetet e bllokuara paraqesin mjetet e transferuara në llogari të bllokuara që kanë të bëjnë me memorandumin e nënshkruar në mes të Byrosë dhe Shoqatës së Siguruesve të Serbisë.

12 TË ARKËTUESHMET

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimit	491	582
	<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>
Të arkëtueshme nga CSO - Shqipëria	990	664
Të arkëtueshme nga CSO - Maqedonia	33	24
Të arkëtueshme nga CSO - Serbia	33	
Minus: Provizioni nga dëmtimet e llogarive tjera të arkëtueshme - Shqipëria	<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>
	(990)	(664)
	<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>
Të arkëtueshme të tjera	142	145
Minus: Provizioni nga dëmtimet e llogarive tjera të arkëtueshme	<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>
	(109)	(109)
TË ARKËTUESHMET NETO	590	642

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

13 PRONA, OBJEKTET DHE PAJISJET TJERA

	Pajisjet (në 000 EUR)	Mobilet (në 000 EUR)	Automjetet (në 000 EUR)	Përmirësimet në objektet me qira (në 000 EUR)	Totali (në 000 EUR)
Kosto historike					
1 Janar 2016	239	34	228	78	579
Shtesat gjatë vitit	5	-	15	-	20
31 Dhjetor 2016	244	34	243	78	599
1 Janar 2017	244	34	243	78	599
Shtesat gjatë vitit	1	-	22	4	27
31 Dhjetor 2017	245	34	265	82	626
Zhvlerësimi i akumuluar					
1 Janar 2016	189	25	153	53	420
Zhvlerësimi i vittit	25	1	33	8	67
31 Dhjetor 2016	214	26	186	61	487
1 Janar 2017	214	26	186	61	487
Zhvlerësimi i vittit	19	-	30	6	55
31 Dhjetor 2017	233	26	216	67	542
VLERA NETO E ASETEVE					
31 Dhjetor 2017	12	8	49	15	84
31 Dhjetor 2016	30	8	57	17	112

BKS nuk ka pronë të lënë pengë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016dhe të gjitha pasuritë janë përdorur për aktivitetet operuese të Byrosë

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017****14 PASURITË E PAPREKSHME**

Kosto	Softuer dhe Licenca (në 000 EUR)
Më 1 Janar 2016	136
Shtesat gjatë vitit	
Më 31 dhjetor 2016	136
Shtesat gjatë vitit	
Më 31 dhjetor 2017	136
Zhvlerësimi i akumuluar	
Më 1 janar 2016	74
Shtesat gjatë vitit	20
Më 31 dhjetor 2016	94
Shtesat gjatë vitit	
Më 31 dhjetor 2017	20
Vlera neto ne libra	
Më 31 dhjetor 2017	22
Më 31 dhjetor 2016	42

15 KOSTO E SHTYRË E PËRVETËSIMIT

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 kosto e shtyrrë e përvetësimit (DAC) ka qenë në shumën prej 38 mijë Euro dhe 45 mijë Euro, respektivisht. Nga viti 2014 kalkulimi i kostos së shtyrrë të përvetësimit bëhet duke u bazuar në udhëzimin administrativ të BQK me nr. 01/2014. Sipas udhëzimit, shpenzimet e lejuara për kalkulim janë shpenzimet e personelit për shitje të primeve, taksa e primeve që është 5% dhe shpenzimet e provizonit te BQK 1.5%. Pasi që BQK nuk ka obligim ndaj dy kategorive të mësipërme, DAC i kalkuluar për vitin 2017 dhe 2016 paraqet vetëm pjesën e pa amortizuar të shpenzimeve të personelit për shitjet e primeve.

	2017 (në 000 EUR)	2016 (në 000 EUR)
Shpenzimet e personelit	38	45
TOTALI	38	45

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

16 TË ARKËTUESHMET NGA KOMPANITË E SIGURIMIT PËR REZERVAT TEKNIKE

**31 Dhjetor
2017
Gjithsej**

	Fondi i Kompenimit (në 000 EUR)	Sigurimi kufitar (në 000 EUR)	(në 000 EUR)
Eurosig	992	733	1,725
Siguria	937	694	1,631
Sigal	927	721	1,648
Illyria	861	627	1,488
Kosova e re	852	670	1,522
Sigma	834	696	1,530
Elsig	843	695	1,538
Insig	720	592	1,312
Dukagjini	563	577	1,140
Sig-Kos	410	454	864
Scardian	174	221	395
Prisig	202	255	457
TOTALI	8,315	6,935	15,250

**31 Dhjetor
2016
Gjithsej**

	Fondi i Kompenimit (në 000 EUR)	Sigurimi kufitar (në 000 EUR)	(në 000 EUR)
Eurosig	1,658	686	2,344
Siguria	1,522	642	2,164
Sigal	1,521	658	2,179
Illyria	1,382	593	1,975
Kosova e re	1,407	630	2,037
Sigma	1,375	632	2,007
Elsig	1,420	630	2,050
Insig	1,047	505	1,552
Dukagjini	865	493	1,358
Sig-Kos	673	431	1,104
Scardian	287	135	422
Prisig	360	165	525
TOTALI	13,517	6,200	19,717

Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit përfshijnë shumat nga kompanitë e sigurimeve për dëmet e vlerësuara në të ardhmen (RBNS dhe IBNR). Për këto të arkëtueshme nuk ka orar ri pagese të rënë dakord ndërmjet Byrosë dhe kompanive të sigurimit. Menaxhmenti është i sigurt në mënyrë të arsyeshme që shumat e tillë do të mbulohen plotësisht në të ardhmen prandaj nuk është njojur ndonjë lejim për këto të arkëtueshme në pasqyrat financiare.

17 DETYRIMET E SIGURIMIT PËR HUMBJE DHE SHPENZIMET E RREGULLIMIT TË HUMBJEVE

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Detyrimet bruto të sigurimit për humbje dhe shpenzime të përmirësimit të humbjeve 01 janar	19,717	18,702
Sigurimit dhe shpenzimet e përmirësimit të humbjeve gjatë vitit	1,102	6,175
Humbjet dhe shpenzimet e përmirësimi të humbjeve të paguara gjatë vitit	<u>(5,569)</u>	<u>(5,160)</u>
TOTALI	15,250	19,717

18 REZERVAT E PRIMIT TË PAFITUAR

Ndryshimi në primin e pafituar është si në vijim:

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Primet e pafituara më 01 janar	476	450
Primi kufitar i pafituar më 31 dhjetor	<u>460</u>	<u>476</u>
TOTALI	16	(26)

19 DETYRIME TË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 EUR)
Të pagueshmët ndaj kompanive të sigurimit (Depozitat në Bankë - EMOU Serbia)	1,500	1,500
Të pagueshmët ndaj kompanive të sigurimit	445	394
Shërbimet e sigurimit	28	13
Detyrimet ndaj punëtorëve	3	4
Të pagueshmët e tjera ndaj kompanive të sigurimit	<u>109</u>	<u>109</u>
Minus: Provizioni për të pagueshmët e tjera (shënim 12)	<u>(109)</u>	<u>(109)</u>
TOTALI	1,976	1,911

19 DETYRIME TË TJERA (VAZHDIM)

Të pagueshmet ndaj kompanive të sigurimit më 31 dhjetor 2017 në vlerë 445 mijë përbajnjë detyrimin e Kompanive të Sigurimit 394 mijë dhe vlerën prej 51 mijë e cila është paraja në pika kufitare që nuk është deponuar në bankë në Dhjetor dhe hynë në kalkulimin e kuotës në Janar 2018.

Të pagueshmet e tjera ndaj kompanive të sigurimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 në vlerë prej 109 mijë Euro paraqesin paranë e vjedhur në një nga pikat e shitjes së Byrosë dhe zyrën kryesore gjatë viteve paraprake.

20 TË ARKËTUESHMET / TË PAGUESHMET NDAJ KOMPANIVE TË SIGURIMIT PËR TEPRICAT E AKUMULUARA

Balancat prej 42 mijë Euro (e arkëtueshme) dhe 96 mijë Euro (e pagueshme) më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, respektivisht, paraqesin tepricën neto të akumuluar nga vitet paraprake si dhe mungesën aktuale për vitin 2017 në vlerë prej 138 mijë Euro. Byroja nuk e mbanë këtë bilanc si tepricë të akumuluar, prandaj është njojur si e pagueshme ndaj kompanive të sigurimit, më një shpenzim përkatës për atë vit (shih shënimin 9), kur deficiti është regjistruar si e hyrë dhe si rënie e të pagueshmeve të kompanive të sigurimit (shih shënimin 8). Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Byroja nuk ka alokuar këtë balancë kompanive të sigurimit, duke u varur nga vendimi i Këshillit Administrativ të Byrosë.

21 KONTINGJENCAT DHE ZOTIMET*Çështje gjyqësore*

Byroja është e përfshirë në pretendime të ndryshme që lidhen me biznesin e saj të sigurimit. Më 31 dhjetor 2017, ka një numër të lartë të çështjeve gjyqësore për të cilat raste, në bazë të menaxhimit dhe të vlerësimin më të mirë të departamentit ligjor, byroja ka njojur provisionet të dëmeve të pazgjidhura - Të raportuara por jo të rregulluara. Sipas menaxhmentit dhe mbrojtësit e tyre ligjor, rezultati përfundimtar i çështjes në datën e raportimit nuk mund të përcaktohet me ndonjë besueshmëri .

Detyrimet e tatimit

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, 2016, 2015, 2014, 2013 dhe 2012 libri i taksave të Byrosë dhe regjistrimet nuk janë inspektuar nga autoritetet tatimore lokale. Byroja ka ndjekur rregullat dhe rregulloret gjatë llogaritjes së detyrimeve tatimore, sidoqoftë, interpretimet tatimore për autoritetet tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga Byroja.

Zotimet kapitale

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 që nuk janë njojur (në çoftë se ka) në pasqyrat financiare.

22 TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Transakzionet me palët e ndërlidhura

Byroja ka transaksione të palëve të ndërlidhura me të gjitha kompanitë e sigurimit gjatë aktiviteteve në rrjedhën normale të biznesit. Të gjitha këto transaksione janë bartur në afate dhe kushte komerciale dhe me çmime të tregut. Tabela më poshtë tregon volumin e bilanceve nga transaksionet e palëve të ndërlidhura më dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

31 dhjetor 2017

	Pasuritë	Detyrimet	Të hyrat	Shpenzimet
Anëtarët e Asamblesë	-	-	-	-
Këshilli administrativ	-	-	-	-
Menaxhmenti i lartë	-	-	-	120
Shpenzimet	-	-	-	37
Sigurimi shëndetësor	-	-	-	5
Llogaria rrjedhëse	72	-	-	-
TOTALI	72	-	-	162

31 dhjetor 2016

	Pasuritë	Detyrimet	Të hyrat	Shpenzimet
Anëtarët e Asamblesë	-	-	-	62
Këshilli administrativ	-	-	-	59
Menaxhmenti i lartë	-	-	-	106
Shpenzimet	-	-	-	33
Sigurimi shëndetësor	-	-	-	28
Llogaria rrjedhëse	67	-	-	-
TOTALI	67	-	-	288

23 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Pas fund vitit dhe deri në lëshimin e këtyre pasqyrave financiare, gjatë vitit 2017, menaxhmenti i Byrosë ka lëshuar një vendim për provizionimin e të gjitha balancave të të arkëtueshme nga CSO Shqipëria sipas 31 dhjetor 2017 në vlerë prej 326 mijë Euro e cila ka qenë e njobur në llogaritë e Byrosë në vitin 2017.

Përveç shpalosjes së mësipërme, nuk ka rregullime tjera që reflektojnë në pasqyrat financiare apo ngjarje të tjera të rëndësishme që janë materiale që të shpalosen në këto pasqyra financiare

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

RAPORT AUDITIMI AKTUARISTIK

Për përllogaritjen e rezervave teknike me datë 31 Dhjetor 2017

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

PËRMBLEDHJA

	Faqe
1. QËLLIMI DHE BAZA E AUDITIMIT	1
2. GJETJET E AUDITIMIT	2
2.1 REZERVA E DËMEVE	3
2.1.1 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA DHE TË RAPORTUARA - RBNS	3
2.1.2 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA PORT TË PA RAPORTUARA - IBNR	3
2.1.3 REZERVA PËR SHPENZIME TË TRAJTIMIT TË DËMEVE	9
3. MENDIMI AKTUARISTIK	9

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

1. QËLLIMI DHE BAZA E AUDITIMIT

Nga ana e kompanisë së auditimit BDO Kosova L.L.C. me seli në Rr. Pashko Vasa Nr. 46, Prishtinë, Republika e Kosovës, jam angazhuar si ekspert i jashtëm aktuar i licencuar, për të bërë auditim të punës së Byrosë Kosovare të Sigurimit në këto lëmi:

- Auditim i pavarur i përllogaritjes së rezervave teknike të Byrosë me datë 31 Dhjetor 2017, edhe atë:
 - o Rezervave për primin e pa fituar dhe rrezikun e pa skaduar (Unearned Premium Reserve - UPR dhe Unexpired Risk Reserve - URR)
 - o Rezervave për dëmet e ndodhura dhe raportuara (RBNS - Reported But Not Settled)
 - o Rezervave për dëmet e ndodhura por të pa raportuara (IBNR - Incurred But Not yet Reported)
 - o Rezervave tjera që ndan Kompania për mbarëvajtje të punës, me qëllim që të mund të mbulojë obligimet që dalin nga lidhja e kontratave të sigurimit
- Kontrollim i metodave të përdorura për llogaritje të rezervave
- Kontrollimi i rezervave është bërë për:
 - o Fondin e Kompenzimit (RBNS dhe rezerva për trajtimin e dëmeve)
 - o Sigurimin Kufitar (UPR, URR, RBNS, IBNR dhe rezervat për trajtimin e dëmeve)

Për këtë qëllim si bazë janë marrë të dhëna relevante, që i kam kërkuar dhe më janë siguruar nga ana e Byrosë. Paralelisht më janë sigruar dhe kam shqyrtuar raportet e aktuarit për fondin e kompensimit dhe sigurimin kufitar.

Të dhënat e kërkuara dhe siguruara kanë qenë të mjaftueshme që të mund të jap mendim relevant në lidhje me qëllimet e lartpërmendura.

2. GJETJET E AUDITIMIT

Rezervat për primin e pa fituar dhe rrezikun e pa skaduar

Auditimi i rezervave për primin e pa fituar dhe rrezikun e pa skaduar është bërë në bazë të të dhënave që janë ofruar nga Byroja, e që përbajnjë të gjitha elementet e duhura për të bërë auditim të plotë të këtyre rezervave. Të dhënrat janë siguruar për çdo policë aktive veçmas, me qëllim që të mund të bëhet kontrolli i llogaritjes në nivel të policës.

Byroja mban rezerva për primin e pa fituar (UPR) dhe rrezik të pa skaduar (URR) vetëm për Sigurimet Kufitare dhe jo për Fondin e Kompenzimit.

Byroja bën llogaritjen e rezervës për primin e pa fituar sipas metodës Pro Rata Temporis, d.m.th. në përpjesëtim të drejtë me kohën e mbetur të policës, edhe atë për çdo policë veçmas. Kjo metodë është në përputhje të plotë me praktikën botërore aktuaristike, si dhe me Rregulloren për vlerësim dhe mbajtje të provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jo-jetë.

Për të kontrolluar llogaritjen kam shqyrtuar data bazën e primeve të policave kufitare për vitin 2017 dhe kam bërë llogaritjen pavarësisht llogaritjeve të Byrosë. Shuma e fituar përputhet plotësisht me shumën e llogaritur dhe paraqitur nga Byroja.

Me këtë konstatoj se Kompania i ka llogaritur rezervat për primi i pa fituar - UPR në mënyrë adekuate.

Rezerva për rrezikun e pa skaduar llogaritet nëse konstatohet se rezerva për primë të pa fituar nuk mjafton për të përbushur obligimet për policat aktive. Nga LAT analiza konstatohet se Byroja nuk ka nevojë për të ruajtur rezervë të posaçme për rrezik të pa skaduar pasi primi i pa fituar mbulon obligimet e ardhshme që do t'i ketë Kompania nga policat aktive.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2.1 REZERVA E DËMEVE

Byroja ka llogaritur rezerva për dëmet e raportuara (RBNS), të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) dhe rezerva për shpenzime të trajtimit të dëmeve. Rezerva për dëme të raportuara dhe për shpenzime trajtimi mbahen për Fondin e Kompenzimit dhe për Sigurimet Kufitare, ndërsa rezerva IBNR vetëm për Sigurimet Kufitare.

Për të bërë auditim më janë siguruar të dhëna relevante që përbajnjë të gjitha elementet e duhura për të kryer auditim të plotë të këtyre rezervave.

Më poshtë është tabela për rezervat e dëmeve për të gjitha llojet:

	Fondi i Kompenzimit	Sigurimet Kufitare	Total
UPR	0	459.843	459.843
RBNS	8.152.652	4.314.952	12.467.604
IBNR	0	2.483.328	2.483.328
Rezerva për trajtim	163.053	135.966	299.019
Total	8.315.705	7.394.089	15.709.794

2.1.1 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA DHE TË RAPORTUARA - RBNS

Auditimi i këtyre rezervave është bërë nga lista e dëmeve të paraqitura, por akoma të pa likuiduara nga ana e kompanisë. Byroja mban rezerva për secilin dëm veçmas, duke u nisur nga përvaja paraprake dhe vlerësimi i ekspertëve rast për rasti. Kjo lloj llogaritje është adekuate dhe në përputhje me metodat e pranuara aktuaristike, ndërsa përgjegjësinë për secilën rezervë veçmas e mban Byroja dhe kompanitë anëtarë të saj. Sidoqoftë aktuari mund të kompensojë mungesat eventuale gjatë përllogaritjes së IBNR, pjesa IBNER (Incurred But Not Enough Reserved). Mendimi jonë është se këto rezerva duhet pranuar ashtu siç janë, ndërsa mungesa eventuale mund të llogaritet dhe regjistrohet gjatë llogaritjes së IBNR.

2.1.2 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA POR TË PARAPORTUARA - IBNR

Byroja llogarit rezerva IBNR vetëm për Sigurimet Kufitare. Për të testuar mjaftueshmërin e rezervave kam shqyrta kalkulimet e aktuarit, listën analitike të secilit dëm të paraqitur ku shihen datat e aksidentit dhe paraqitjes së dëmit, vitet e pagesës dhe rezervat aktuale për dëme të grumbulluara sipas vitit të aksidentit.

Byroja ka llogaritur rezervat IBNR duke përdorur metodën e trekëndëshave, ashtu që ka bërë analizë të numrit të dëmeve të paraqitura për secilin vit dhe projeksion të tyre në të ardhmen. Më pas numrin e dëmeve të fituar nga projekioni e ka shumëzuar me vlerën mesatare të një dëmi IBNR, me çka fitohet vlera totale e IBNR. Kjo vlerë se bashku me RBNS është krahasuar vit për vit dhe janë bërë korrigjime adekuate për vitet ku është vlerësuar se ka mangësi.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2.1.2 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA POR TË PARAPORTUARA - IBNR (VAZHDIM)

Analitikisht procedura rrjedh si më poshtë:

Pasqyrë e numrit të dëmeve të paraqitura, sipas vitit të aksidentit (rreshti) dhe vonesës së vitit të paraqitjes (kolona):

	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2006	289	90	13	13	5	3	3	2	1	1	0	0
2007	432	93	25	14	5	6	2	1	0	0	0	
2008	459	130	19	12	4	6	5	7	1	0		
2009	625	126	31	13	13	8	7	1	3			
2010	574	110	17	25	15	11	7	1				
2011	688	141	40	31	24	14	2					
2012	922	118	38	23	12	6						
2013	977	147	37	25	22							
2014	932	159	40	29								
2015	882	172	55									
2016	1050	163										
2017	970											

E njëjtë pasqyrë është dhënë në mënyrë kumulative më poshtë:

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
2006	289	379	392	405	410	413	416	418	419	420	420	420
2007		432	525	550	564	569	575	577	578	578	578	578
2008			459	589	608	620	624	630	635	642	643	643
2009			625	751	782	795	808	816	823	824	827	
2010			574	684	701	726	741	752	759	760		
2011			688	829	869	900	924	938	940			
2012		922	1040	1078	1101	1113	1119					
2013			977	1124	1161	1186	1208					
2014			932	1091	1131	1160						
2015			882	1054	1109							
2016			1050	1213								
2017		970										
Faktori i llogaritur		1.185	1.039	1.026	1.016	1.012	1.008	1.005	1.001	1.001		
Faktori i përdorur		1.193	1.039	1.025	1.016	1.010	1.006	1.004	1.002	1.001	1.000	1.011

Në rreshtin e parafundit janë dhënë koeficientet e llogaritur, ndërsa në rreshtin e fundit faktorët që janë përdorur gjatë projekzionit, sipas vlerësimit të aktuarit. Vërehet se gjithkund janë përdorur koeficientet e fituar me korrigjime minimale sipas vlerësimit, përvèç vitit të parë ku korrigjime është më i madh. Aktuari ka përjashtuar nga llogaritja vitin 2012 duke e konsideruar si "outlier".

2.1.2 REZERVA PËR DËME TË NDODHURA POR TË PARAPORTUARA - IBNR (VAZHDIM)

Për të parë nëse ky përjashtim është valid, kam ndërtuar tabelën e koeficienteve për secilin vit si më poshtë:

	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
2006		1.31	1.03	1.03	1.01	1.01	1.01	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
2007		1.22	1.05	1.03	1.01	1.01	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
2008		1.28	1.03	1.02	1.01	1.01	1.01	1.01	1.00	1.00			
2009		1.20	1.04	1.02	1.02	1.01	1.01	1.00	1.00				
2010		1.19	1.02	1.04	1.02	1.01	1.01	1.00					
2011		1.20	1.05	1.04	1.03	1.02	1.00						
2012		1.13	1.04	1.02	1.01	1.01							
2013		1.15	1.03	1.02	1.02								
2014		1.17	1.04	1.03									
2015		1.20	1.05										
2016		1.16											
2017													

Vërehet se viti 2012 vërtetë është i jashtëzakonshëm në vitin e parë të zhvillimit dhe me këtë arsyetohet ç kyçja e tij nga llogaritja e koeficienteve. Për më tepër ç kyçja ka rezultuar me koeficient më të madh dhe IBNR më të madhe, që është veprim i matur dhe i kujdeshshëm.

Pas llogaritjes së faktorëve është bërë projekioni i numrit të dëmeve në të ardhmen, llogaritja e dëmeve të mbeturë dhe shumëzimi me vlerën mesatare të dëmit IBNR (2950,44 Euro), për të fituar vlerë për IBNR:

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

Projekcion i numrit dhe vlerës së dëmeve:

	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		Dëme të mbeturat	IBNR
2006	289	379	392	405	410	413	416	418	419	420	420	420	425	5	14,752
2007	432	525	550	564	569	575	577	578	578	578	578	578	584	6	17,703
2008	459	589	608	620	624	630	635	642	643	643	643	643	650	7	20,653
2009	625	751	782	795	808	816	823	824	827	828	828	828	837	10	29,504
2010	574	684	701	726	741	752	759	760	762	762	762	762	770	10	29,504
2011	688	829	869	900	924	938	940	944	945	946	946	946	956	18	53,108
2012	922	1040	1078	1101	1113	1119	1126	1130	1133	1133	1133	1133	1146	27	79,662
2013	977	1124	1161	1186	1208	1221	1228	1233	1235	1236	1236	1236	1250	42	123,919
2014	932	1091	1131	1160	1178	1191	1198	1203	1205	1206	1206	1206	1219	59	174,076
2015	882	1054	1109	1137	1155	1167	1175	1179	1181	1182	1182	1182	1195	86	253,738
2016	1050	1213	1260	1292	1313	1327	1335	1340	1343	1344	1344	1344	1358	145	427,814
2017	970	1157	1202	1233	1252	1265	1273	1278	1281	1281	1281	1281	1295	325	958,894
														740	2,183,327

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

Përfundimisht vlera e fituar është mbledhur me dëmet e paguara dhe dëmet në rezervë RBNS, për të fituar një total për [do vit që mund të krahasohet me vitet tjera:

	Paguara	RBNS	IBNR	TOTAL
2006	534,058	71,409	14,752	620,219
2007	1,000,148	44,849	17,703	1,062,700
2008	842,104	217,610	20,653	1,080,367
2009	1,501,695	259,279	29,504	1,790,478
2010	1,113,920	122,310	29,504	1,265,734
2011	1,215,252	1,078,398	53,108	2,346,758
2012	1,079,290	349,408	79,662	1,508,360
2013	1,311,207	485,880	123,919	1,921,006
2014	1,019,732	379,814	274,076	1,673,622
2015	883,839	338,090	453,738	1,675,668
2016	1,129,655	392,799	427,814	1,950,268
2017	537,079	445,835	958,894	1,941,808
TOTAL	12,167,980	4,314,952	2,483,327	

Për të arritur përputhje mes viteve aktuari ka bërë dy korrigjime: ka rritur vlerën e IBNR në vitin 2014 për 100,000 Euro dhe në vitin 2015 për 200,000 Euro. Me këtë vlera e IBNR e fituar nga llogaritja më lartë është shtuar për 300,000 Euro dhe është fituar vlera përfundimtare e evidentuar zyrtarisht si IBNR.

Mendimi ynë

Metoda më relevante për llogaritje të IBNR është ndonjë variacion i metodës së trekëndëshave, nëse për përdorim të tij janë plotësuar kushtet. Në këtë mënyrë konstatojmë se metoda e projekzionit të numrit të dëmeve, që ka përdorur BKS, është e arsyeshme dhe relevante, pasi zhvillimi i dëmeve tregon trend konstant me çka plotësohen kushtet për përdorim të kësaj metode. Gjithashtu gjykoj se korrigimet e bëra janë adekuate; për më tepër ato rezultojnë me rritje të IBNR që është veprim i matur dhe i kujdeshëm.

Mirëpo metoda e përdorur jep vetëm rezultat të arsyeshëm për IBNR dhe nuk merr parasysh mangësinë që mund të kenë rezervat RBNS, gjegjësisht nuk mbulon pjesën e rezervave IBNER (Incurred but Not Enough Reported).

Për të testuar nëse ka mangësi eventuale kam përdorur një variant tjetër të metodës së trekëndëshave, gjegjësisht metodën me projeksion të vlerave për tetë vitet e fundit, që është periudhë e mjaftueshme pasi mangësitë në RBNS zakonisht ndodhin për vitet e fundit. Llogaritja është si më poshtë:

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

Pasqyrë e vlerave të dëmeve sipas vitit të aksidentit dhe vitit të zhvillimit (pagesës), kumulative:

	0	1	2	3	4	5	6	7
2010	550,098	910,471	971,490	1,068,484	1,086,359	1,093,500	1,100,945	1,113,920
2011	474,321	829,835	973,169	1,060,901	1,132,717	1,145,735	1,215,252	
2012	575,769	916,776	982,888	1,023,815	1,051,791	1,079,290		
2013	536,396	933,846	1,028,519	1,206,733	1,311,207			
2014	646,190	853,566	978,475	1,019,732				
2015	461,571	784,234	883,839					
2016	540,078	1,129,655						
2017	537,079							
Koeficienti		1.680	1.113	1.090	1.051	1.015	1.034	1.012

Projekcion në të ardhmen:

	0	1	2	3	4	5	6	7	Paguara	RBNS	IBNR
2010	550,098	910,471	971,490	1,068,484	1,086,359	1,093,500	1,100,945	1,113,920	1,113,920	122,310	0
2011	474,321	829,835	973,169	1,060,901	1,132,717	1,145,735	1,215,252	1,229,575	1,215,252	1,078,398	0
2012	575,769	916,776	982,888	1,023,815	1,051,791	1,079,290	1,116,385	1,129,543	1,079,290	349,408	0
2013	536,396	933,846	1,028,519	1,206,733	1,311,207	1,330,312	1,376,035	1,392,253	1,311,207	485,880	0
2014	646,190	853,566	978,475	1,019,732	1,071,688	1,087,303	1,124,673	1,137,929	1,019,732	379,814	0
2015	461,571	784,234	883,839	963,567	1,012,661	1,027,416	1,062,728	1,075,254	883,839	338,090	0
2016	540,078	1,129,655	1,257,048	1,370,441	1,440,266	1,461,251	1,511,474	1,529,288	1,129,655	392,799	6,834
2017	537,079	902,371	1,004,133	1,094,712	1,150,488	1,167,251	1,207,369	1,221,599	537,079	445,835	238,685
											245,519

Projekioni jep vlerë më të vogël se ajo që është fituar me projekcion të numrit të dëmeve, që do të thotë se nuk ekziston faktor IBNER për të ndryshuar vlerësimin fillestar. Kjo do të thotë se IBNR e llogaritur nga Byroja është në nivel të mjaftueshëm.

2.1.3 REZERVA PËR SHPENZIME TË TRAJTIMIT TË DËMEVE

Si pjesë e rezervave teknike për dëme Byroja ruan edhe rezerva për shpenzime për trajtim të dëmeve. Duke u nisur nga përvoja paraprake Byroja i llogarit këto rezerva si 2% të shumës së RBNS për Fondin e Kompenzimit dhe 2% të shumës së RBNS dhe IBNR për Sigurimet Kufitare, nivel që është i arsyeshëm sipas praktikës aktuaristike. Pra mund të konstatojmë se këto rezerva janë në nivel të duhur.

3. MENDIMI AKTUARISTIK

Nga Auditimi i pavarur aktuaristik i metodave dhe llogaritjeve të rezervave teknike të Byrosë Kosovare të Sigurimeve me gjendjen në datë 31 Dhjetor 2017, konstatoj se Byroja i llogarit rezervat në përputhje me praktikën dhe standartet e pranuara aktuaristike dhe Rregulloren për vlerësim dhe mbajtje të provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jo-jetë.

Konstatimi vlen për të gjitha llojet e rezervave të llogaritura, njëkohësisht për Fondin e Kompenzimit dhe Sigurimet Kufitare.

Ky konstatim është bazuar mbi përpunimin e të dhënavë që më janë siguruar nga Byroja, e që kanë përbajtur të gjitha elementet e nevojshme për të dhënë mendim përfundimtar mbi nivelin e rezervave teknike.

Aktuar i autorizuar
Robert Nesimi
23 Shkurt 2018